



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Nr. 021/16
Datë: 06.10.2016

Bazuar në nenin 9 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit për Trashëgimi Kulturore, nenin 4.1 të Rregullores 01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, nenet 2.18, 2.19 të Rregullores 02/2016 për Vlerësimin dhe Shpalljen e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përhershme, nenet 4.4, 4.5 dhe 4.6 të Rregullores 05/2005 mbi Regjistrimin, Dokumentimin, Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, pasi shqyrtoi propozimin e asetit të trashëgimisë kulturore **“Patrikana e Pejës”** nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në mbledhjen e datës 06.10.2016, merr:

V E N D I M

1. S H P A L L në mbrojtje të përhershme asetit e trashëgimisë kulturore arkitekturore **“Patrikana e Pejës”** me numër unik TKRKS1A012, bazuar në kriteret dhe vlerat historike, artistike, shoqërore, shpirtërore.
2. **“Patrikana e Pejës”** gjendet në Pejë, zona kadastrale Pejë, me zonë mbrojtëse 230.56 Ha, sipas hartës së bashkangjitur, përbën asetit e shpallur në kuadër të kategorisë trashëgimi arkitekturore.
3. MKRS obligohet që të përfshijë në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme asetit e shpallur me këtë vendim.
4. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që brenda afatit gjashtë (6) muajsh të hartojë planin e administrimit – menaxhimit për asetit e lartcekur.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetar i KKTK
Shafi Gashi

Ky vendim i dërgohet:

- Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Arkivit të KKTK